



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER SOKOL SH. MALAJ
ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI
TEL: 684055554**

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 2350

Tirane më 04/11/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterine"



V2021050710137039673



AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"4U Albania" Sh. p. k

Në Tiranë më datë 04 Nëntor 2021 (dymjë e njëzet e një) ditën e enje, unë i nënshkruari **Z.PAOLINO MANFREDI** i biri i Vittorio dhe Agata lindur Baucina (PA), Itali më 17.08.1959, banues në Itali, Via Giacomo Leopardi 21 Cap 20123, i identifikuar me Pasaportën italiane Nr YB8143520, Administrator i vetëm i shoqërisë **"4U Italia" S.r.l;**

i cili me këtë cilësi, ka certifikuar edhe Proçesverbal i Asamblesë totalitare te ortakëve (mëmë) **"4U Italia" Srl** të datës 16.09.2021 (bashkangjitur dhe me Vulë Apostile), akt ky i hartuar në prezencë të Blue Matrix Investments Limited në personin e Dr. Orlando Taddeo në cilësinë e Drejtlorit, Paolino Manfredi Administrator i Vetëm dhe Dr. Alfredo Fossati Auditues i Vetem, dhe nënshkruar nga Av. Alice Tarantino e cila eshtë caktuar në detyrën e Sekretarit nga të pranishmit e mbledhjes;

jam caktuar për krijimin (**hapjen**) e një Shoqërie në Republikën e Shqipërisë, i cili deklaron se nuk e kuption gjuhën shqipe dhe asistohet në gjuhën italiane nga përkthyesi i tij i besuar **Z.YLLI LOFCA**, atësia Agim, amësia Lirije, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë më 06/09/1964, dhe banues në Tirane, me adresë 1003 Njesia bashkiake nr. 2 Nasi Pavllo 26 3 35, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034613767 dhe nr. personal G40906019I.—

Në emër dhe për llogari të shoqërisë **"4U Italia" S.r.l** kjo e fundit me cilësinë e ortakut të vetëm dhe me vullnetin tim të lirë e të plotë vendosa të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **"4U Albania" Sh. p.k**, me Qendër në Tiranë.—

Neni 1

EMËRTIMI DHE QENDRA E SHOQËRISË

EMËRTIMI : "4U Albania" Sh. p.k

SELIA: Rr. George W. Bush, Nd.5, K.1 Ap.12 Tiranë

Shoqëria do të jetë person juridik me regjistrimin në QKB sipas nenit 22 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" e në bazë të Ligjit Nr 9901 të datës 14.04.2008 "PËR TREGËTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE". Shoqëria do të gezojë të gjithë të drejtat si peson juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në **Q.K.B.**—

Neni 2
QËLLIMI I SHOQËRISË

Objekti i Shoqërisë do të jetë:

Shoqëria ka si objekt:





A) Ofrimin e shërbimeve për konsumatorët, kompanitë dhe subjektet publike dhe private, dhe përmes "Call Center" dhe "Contact Center" ose mjeteve të tjera të transmetimit, ruajtjes dhe shkëmbimit të të dhënave sipas teknologjive aktuale dhe të ardhmes, përfshiri - për shembull - internetin, televizionin ndërveprues, telefoninë fikse dhe celulare, transmetimet satelitore, pajisjet elektronike që mundësojnë shërbimet e rrjetit;

B) Promovimi telefonik për lidhjen e kontratave për furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror dhe produkte që lidhen me përdorimin e tyre;

C) Ushtrimin e marketimit dhe kërkimit te tregut, dhe përmes "Call Center" dhe "Contact Center" ose mjeteve të tjera të transmetimit, ruajtjes dhe shkëmbimit të të dhënave sipas teknologjive aktuale dhe ato të ardhshme;

D) Shitia e produkteve dhe / ose shërbimeve në emër të palëve të treta, asistence dhe trajnim për komunikim të drejtpërdrejtë, promovimi dhe shpërndarja e shërbimeve, për llogari të vet ose si agjenci brokerimi, të gjitha në përputhje rigoroze me rregullat ne fuqi. Gjithashtu te krijoje sisteme të anëtarësimit tregetar per aktivitetet e përshkruar me sipër;

E) shitjet telefonike të abonimeve të revistave / gazetave, produkteve ushqimore dhe produkteve teknologjike;

F) Krijimi i aplikacioneve dhe zgjidhjeve informatike (i njohur zakonisht si - software) dhe zbatimi i, personalizimi, asistenca tekniqe, blerja, transferimi dhe shfrytëzimi tregtar në çdo formë, qoftë software ne pronesi ose i blerë me përdorim licence; shfrytëzimi ekonomik nën çfarëdo forme të teknologjive, teksteve, projekte, marka, patenta, licenca, produkte, grafikë, informatike dhe pronësisë intelektuale: gjithashtu dhe me koncesion ose per llogari të palëve të treta, në lidhje me teknologjinë e informacionit;

G) Studimin, planifikimin, zhvillimin dhe menaxhimin, si për llogarinë e vete ashtu edhe për palët e treta, të bazave të të dhënave dhe arkiveve të informacionit të strukturuar për futjen, kerkimin, përditësimin, monitorimin dhe anulimin e të dhënave, me ndihmën, por jo ekskluzivisht, të sisteme kompjuterike; menaxhimin e "Data Warehouse" dhe mjeteve për lokalizimin e të dhënave, nxjerrjen, transformimin dhe ngarkimin e tyre, "datatiming", "Information retrieval" dhe në përgjithësi outsourcing e e proceseve informatike , arkivimin elektronik të të dhënave; krijimin e treguesve, raporteve dhe përbledhjeve të të dhënave të përpunuara.

H) Organizimi, mbajtja, koordinimi i seminareve, simpoziumeve, takimeve, planeve dhe kurseve kolektive dhe individuale, trajnimi i personelit në fushën e teknologjisë së informacionit (me përjashtimin e ndërmjetësimit në vendosje).

I) Analiza, projektim, zhvillim, dokumentim, instalim i sistemeve informatike telematike dhe te rrjeteve te ekzekutimit te shërbimeve të lidhura me to;



2



I) Aktivitet publikimi (përjashto botimin e gazetave), trajnimi dhe konsulencia në përgjithësi në çështjet që lidhen me teknologjinë e informacionit, automatizimin dhe organizimin, gjithashtu në lidhje me menaxhimin e biznesit;

K) Blerja, transformimi, shitja dhe marrja me qira të pajisjeve dhe sistemeve në përgjithësi për teknologjinë e informacionit dhe automatizimin, si të prodhimit vetjak ashtu edhe të përfaqësimit;

l) Projektimin, realizim, instalimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin, me çdo teknikë, mjete dhe sistem, të impianteve dhe rrjeteve të telekomunikacionit, në pronësi të kompanisë ose të palëve të treta, qofshin fiks, te levizhme ose satelitore, për përhapjen e aktivitetit, pa kufij territorialë, të shërbimeve të komunikimit që rezultojnë gjithashtu nga evoluimi i teknologjive;

M) Ushtrimi i aktiviteteve të konsulencës informatike dhe telematike për shoqerite, kompanitë, organet publike, studiot profesionale, duke përfshirë, në veçanti: analizën e produkteve informatike ekzistuese në tregun vendas dhe të huaj; Kontrolli i korrektësisë së këtyre produkteve përmes përdorimit të programeve të certifikimit, të dizajnuara për të verifikuar kriticitetin e tyre si në lidhje me harduerin (kompjuterin, pajisjet periferike, memorie) ashtu edhe softuerin (sisteme operative, gjuhë, shërbime, paketa aplikimesh, etj.); çdo shtesë me veçori të reja;

N) Tregetim, asistence dhe mirëmbajtje e produkteve informues, si dhe ofrimi i shërbimeve grafike;

O) Shitblerja, shkembimi, importi, eksporti, koncesioni në përdorim ose me qira, shitja dhe në përgjithësi përdorimi i pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të të gjitha llojeve, përfshirë ato të regjistruara në regjistrat publik;

P) Blerja, si veprimtari jo kryesore, të intesave dhe pjesëmarrjes në kompani ose ndermarje në përgjithësi që kryejnë veprimtari që janë brenda qëllimit shoqëror ose në çdo rast të lidhur me të, plotësuese ose te ngjashme, në përputhje me kufijtë e parashikuar nga legjislacioni aktual në kete fushe;

Q) Furnizimi ne favor te palëve të treta, organeve publike dhe private, të konsulencës tekniqe dhe administrative, shërbimeve të përpunimit të të dhënave, përfshirë projektimin, studimin e programeve të përpunimit të të dhënave dhe furnizimin e të dyjave, për çfarëdo titulli.

R) Ushtrimi subjekt i regjistrimit ne seksionin përkatës "E" të regjistrit të krijuar në përputhje me nenin. 109 i Dekretit Legjislativ nr. 209/2005, aktivitet i ndërmjetësimit ne sigurime, në përputhje dhe në lidhje me atë që parashikohet në kodin e sigurimeve dhe ndryshimet vijuese dhe shtesat, dhe kesisoj për të paraqitur dhe propozuar produkte të sigurimit si dhe te japë asistence dhe konsulence per te finalizuar kete aktivitet. Shoqëria gjithashtu mund te kryejetë gjitha veprimet tregtare, te pasurive të luajtshme e te paluajtshme dhe ato financiare, dhe në çdo rast në një mënyrë mbizotëruese dhe jo per publikun, të konsideruara të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit të shoqerise, përfshirë ketu lëshimin e e fideiusioneve dhe garancive të tjera, gjithmonë nëse një lëshim i tillë nuk konfigurron aktivitetin e



dhënes se financimeve e ushtruar “ndaj publikut”. Shoqeria mund te kryeje mbledhjen e kursimeve me anë të marrjes së fondeve me detyrimin e rimbursimit, pranë ortakve, në përputhje me dispozitave të komitetit ndërministror për kreditinë dhe kursimin e miratuar me vendimin n. 1058 date 19 korrik 2005, ndryshimet dhe shtesat e tij të mëvonshme.”

“Ky aktivitet do të zhyillohet në fushën internacionale dhe në atë nacionale”.

Neni 3
REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

“Shoqëria”, në veprimtarinë e saj bazohet në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri tregëtare krijohet me objektivin për të vazduar veprimtarinë për një periudhë kohore pa afat.—

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të ndryshojë rregjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas Legjislacionit Shqiptar. Në këtë rast “Ortaku” do ta përshtasë “Statutin e Shoqerisë”, si dhe regjistrimin e tyre nga organet kompetente Shqiptare.

“Shoqëria” gëzon personalitet juridik nga dita e miratimit dhe e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar në **Q.K.B.**—

“Shoqëria” mund të ketë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqipëtar.

Pasuria mbrohet sipas dispozitave të ligjit ne fuqi.

Neni 4
KAPITALI – THEMELTAR

Për të siguruar funksionimin fillestar të Shoqërisë, “Ortaku i vetëm” formon kapitalin fillestar të shoqërisë prej **100.000 ALL**(njëqind mijë lekë), me një kuotë të vetme me vlerë nominale **100.000 all** (**njëqind mijë lekë**) kuota.—

Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Kapitali themeltar mund të shtohet në vartësi të aktivitetit, nga kontributet plotësuese të ORTAKËVE (*në rast ndryshimi/shtimi të Ortakëve*), sipas përqindjes së tyre në këtë kapital, me përjashtim të rasteve kur vendoset unanimisht e kundërta.—

Kapitali i shoqërisë i kontribuar nga çdo ortak do të regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.—

Neni 5
DREJTAMI I SHOQËRISË

Shoqëria drejtohet nga këto organe:

→Nga Administratori i Përgjithshëm.





Mënyra e emërimit dhe kompetencat e tij përcaktohen nga statuti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Në kuptim të këtij Akti—themelues, **Ortaku i vetëm i shoqërisë është shoqeria "4U Italia" S.r.l.**—

Detyrën e Administratorit të Përgjithshëm do ta kryejë, për një afat kohor **5-vjeçar**, nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, **Z.YLLI LOFCA**.—

**Neni 6
ADMINISTRATORI**

Ortaku i vetëm vendsos që Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë të jetë **Z.YLLI LOFCA** Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, mund të kryejë të gjitha veprimet ligjore që janë në interes të shoqërisë në përputhje me Statutin e Aktin e Themelimit të saj.

Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, do të ketë autoritet të përgjithshëm në aktivitetin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtën e marrjes se çdo ndërmarrje dhe çdo veprimi që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e qëllimit të shoqërisë me përjashtim të rasteve që ligji "Mbi Tregëtaret dhe Shoqëritë Tregëtare" i kufizon. Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, ka të drejtë t'i propozojë mbledhjes së Asamblese së Ortakëve (*në rast ndryshimi/shtimi të Ortakëve*) planin e mbledhjeve duke marrë vendime për zhvillimin e veprimitarive të shoqërisë, duke përcaktuar dhe linjat kryesore të veprimitarisë së shoqërisë.

Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përbushjen e aktivitetit te saj në perputhje me parashikimet në statutin e kësaj shoqerie.

Organi Administrativ (Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë.) është kompetent për të:

- realizuar mbledhjen e Asamblesë duke njoftuar (ortakët kur ka) me shkrim 15 ditë me parë;
- miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- Te marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të vecanta), ndarjen e fitimit, etj.
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- emëruar përfaqësues duke i deleguar të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij.

**Neni 7
BILANCI, VEPRIMTARIA EKONOMIKE, DETYRIMET**

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetërore, sigurimet shoqërore etj. Ortaku i vetëm themelues ose persona të tjerë të autorizuar prej tij kanë të drejtë që me nxjerrjen e bilanceve ekonomike, çdo fund-viti kalendarik, të përfitojnë përqindjet e realizuara nga veprimitaria private.





Shoqëria "4U Albania" Sh.p.k ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.—

Të gjitha mosmarëveshjet me persona fizikë ose juridike, vendas ose të huaj si dhe organet shtetërore, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Afat i veprimtarisë të kësaj Shoqërie është *pa afat të caktuar*, por aktiviteti fillon data e nënshkrimit të këtij akti.

Neni 9

LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Rastet dhe procedura e likuidimit të Shoqërisë, përcaktohen në Statutin e saj.—

Neni 10

DISPOZITA të PËRGJITHSHME

Ky Akt—Themelimi i Shoqërisë ka si aneks Statutin e Shoqërisë. Çdo ndryshim dhe shtesë e e Statutit, bëhet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.—


Çështjet e pa mbuluara nga ky statut do të rregullohen nga legjislacioni Shqipëtar dhe ne veçanti nga Ligji Nr.9901 dt 14.04.2008 „Mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“.

Ky Akt-themelimi nënshkruhet në Tiranë dhe hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe.—

ORTAKU I VETËM

Shoqëria "4U Italia" S.r.l

Perfaqësuar nga Z. PAOLINO MANFREDI


P
A
O
L
I
N
O
S
M
A
N
F
R
E
D
I

Përkthyesi i tij i besuar
Z.YLLI LOFCA


1920

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER SOKOL SH. MALAJ**



**DATE 04/11/2021
NR REP 2350**

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 04 Nëntor 2021 (dy mijë e njëzet e një), diten e enjte, para meje Noter SOKOL SH. MALAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.2, LUIGJ GURAKUQI, u paraqit personalisht:

DEKLARUESI:

Z.PAOLINO MANFREDI i biri i Vittorio dhe Agata lindur Baucina (PA), Itali më 17.08.1959, banues në Itali, Via Giacomo Leopardi 21 Cap 20123, i identifikuar me Pasaportën italiane Nr YB8143520, Administrator i vetëm i shoqërisë “4U Italia” S.r.l

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, dokumentin bashkëlidhur te dates 04.11.2021, bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018“Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
SOKOL SH. MALAJ**

NOTER. SOKOL SH. MALAJ
RR“LUIGJ GURAKUQI” # 2 TIRANË, ALBANIA
Tel: +355 4 222 98 32 / Cek: +895 68 40 5555 4
e-mail: kelimalaj@hotmail.de

**TAKSA E PULLES
U PAGUA**

Fq. 1

